



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 1081 prot.

Tiranë më 14.2.2020

Lënda: Ridërgim mendimi mbi Memorandumin e Mirëkuptimit me Australinë.

MINISTRISË SË BRENDSHME

Tiranë

Në vijim të shkresës tuaj nr.4169/18 Prot., datë 24.01.2020, nëpërmjet të cilës përcaktoni bazën ligjore mbi të cilën mbështetet hartimi i “Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Departamentit të Punëve të Brendshme të Qeverisë së Australisë”, lutemi referojuni vlerësimit ligjor në vijim.

Sikurse jeni në dijeni, në kuadër të legjitimitetit të transferimit ndërkombëtar të të dhënave personale, bazuar në Vendimin nr.8, datë 31.10.2016 të Komisionerit, “Për përcaktimin e shteteve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale”, Australia konsiderohet vend me nivel jo të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale, pasi nuk është pjesë e listës së tij.

Në këto kushte nevojitet që, për legjitimitetin e procesit të transferimit ndërkombëtar të të dhënave të plotësohet njëri nga kriteret e parashikuara në pikën 2, të nenit 8, të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

Ndryshimi i statusit juridik të bashkëpunimit, nga marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar midis dy qeverive, në memorandum mirëkuptimi, nuk bën të mundur legjitimitetin e transferimit referuar germës a), të pikës 2, të nenit 8, të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, ku parashikohet se transferimi ndërkombëtar realizohet nëse autorizohet nga akte ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe që janë të zbatueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Pas analizës së bazës ligjore dërguar nga ana juaj, mbi të cilën mbështetet hartimi i këtij memorandum, Zyra e Komisionerit vlerëson se kjo bazë ligjore nuk justifikon procesin e transferimit, mbështetur në kriteret e vendosura në germën ç), të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr.9887/2008, i cili parashikon se transferimi ndërkombëtar kryhet në rast se është detyrim ligjor i kontrolluesit.

Pika 3, e nenit 128, e ligjit nr. 108/2014 “Për policinë e shtetit” referon përsëri, në kompetencë të Zyrës së Komisionerit për të vlerësuar kriteret ligjore për përpunimin e të dhënave personale në rastin e transferimit.

Sa më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson që procesi i transferimit të të dhënave personale në kuadër të Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Departamentit të Punëve të Brendshme të Qeverisë së Australisë mund të realizohet, vetëm nëse merren masa për t’u plotësuar kriteri ligjor i vendosur në germën a), të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**KOMISIONERI**  
**Besnik Dervishi**



The image shows a circular official stamp in blue ink. The text around the perimeter of the stamp reads "REPUBLIKA E SHQIPËRIE" at the top, "KOMISIONERI PËR TË VLERËSUAR KRIERET LIGJORE PËR PËRPUNIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE" around the middle, and "TIRANË" at the bottom. In the center of the stamp, there is a smaller emblem. A handwritten signature in blue ink, which appears to be "Besnik Dervishi", is written over the stamp.